



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 91

Prishtinë, më 07.10.2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu dhe Sreten Ivanoviq.

Munguan: Mufera Shinik dhe Gëzim Kelmendi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Rron Gjinovci – QHDP; Lumnije Murati – ZPRK; Arton Demhasaj- “Çohu”; Sylë Ahmeti – gazeta “Kosova Sot”; Fidan Rama – Tribuna; Feride Podvorica-MD; Artan Canhasi - EULEX; Lejla Selimi dhe Petrit Hysaj – OSBE.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 11 dhe 15.7. 2013;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit mbikëqyrës të Agjencisë Kosovare të Pronës;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për aktet normative;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Behar Selimi – Propozoi që në rend të ditës të futet edhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e projektligjeve që ndërlidhen me përfundimin e mandatit të EULEX-it. Ju e dini që Kuvendi e ka miratuar një rezolutë, rezoluta e ka obliguar Qeverinë që të përgatitë strategjinë dhe infrastrukturën përkatëse ligjore për një bartje graduale të përgjegjësi nga EULEX-i, tek institucionet tona, pra të implementimit të ligjit deri në qershorin e vitit 2014. Përveç kësaj, ju e dini se është edhe një vendim i Këshillit të Bashkimit Evropian, me të cilin EULEX-it i është vazhduar mandati deri në qershor të vitit 2014. Pra, përveç aspektit politik dhe vullnetit të Kuvendit të Kosovës, e kemi edhe një datë nga Këshilli i Bashkimit Evropian. Andaj, konsideroj se që të jemi në kohë, do të ishte mirë që sot të diskutohet dhe të miratohet në parim, në mënyrë që pastaj të vazhdojmë me procedura tjera, dhe krejt kjo, që tranzicioni të bëhet gradualisht dhe në baza konsensuale me faktorin ndërkombëtar.

Armend Zemaj – Tha se Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar shumë rezoluta, sidomos në këtë vit dhe asnjë prej tyre nuk janë respektuar nga Qeveria. Kjo është për t'u çuditur pse tani kjo rezolutë po respektohet dhe në mënyrë kaq të ngutshme po kërkohet që ky projektligj të kalojë. Ai tha se kujt po i ngutet ta shkurtojë mandatin e EULEX-it, cilat janë arsyet, a janë arsyet që institucionet tona e kanë arritur performancën dhe profesionalizmin për çka thirren, apo ka arsye tjera që tash veç ka filluar EULEX-i për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Prandaj, jam kundër që ky propozim të hyjë në rendin e ditës dhe mendoj se në kohë fushate as që duhet të diskutohet.

Kryetari – Ne e kemi Ligjin për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, për Misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit. Dilema është se a mund ta ndryshojmë një ligj të ratifikuar në Kuvend me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve, dhe së dyti, përmbajtja e këtij ligji thotë se kërkohet nga Presidentja e vendit të nënshkruajë letrën e bashkëpunimit me znj. Ashton, dhe sipas kësaj, duhet të merret vendim i përbashkët dhe i konsoliduar me partnerët evropianë. Mungojnë sqarimet se çka ka ndodhur me rastet në procedurë gjyqimi, hetimi apo në prokurori. Mungon një raportim i qartë se çka ka ndodhur me portat 1 dhe 31 që menaxhohen nga EULEX-i, mungon një sqarim i qartë se çka do të ndodhë me stacionin policor të krijuar në veri dhe si do të jetë hierarkia e komunikimit. Mendoj se është e palogjikshme, e njëanshme dhe jopolitike për të kushtëzuar Bashkimin Evropian me strategjinë e daljes. Mendoj se duhet të diskutohet dhe pastaj të merret vendimi.

Albulena Haxhiu – Qëndrimi i Lëvizjes Vetëvendosje dihet. Ne kemi qenë kundër vazhdimit të misionit të EULEX-it dhe sigurisht që nuk e kemi ndërruar atë qëndrim. Mirëpo, mendoj se propozimi i Beharit është sa për t'u hedhur hi syve qytetarëve, sepse dihet që mandati i EULEX-it, nuk përfundon me një projektligj. Mendoj se edhe strategjia dhe projektligji që janë sjellë sot, duhet të diskutohen në një mbledhje të ardhshme me procedurë të rregullt. Pra, do të votoj kundër propozimit të Beharit.

Arsim Bajrami – Mendoj se detyra jonë si komision, është që të diskutojmë propozimin e Beharit në aspektin e procedurave që duhet të ndiqen, pra për ta diskutuar, e jo t'i japim në këtë fazë propozimit vlerësime politike. Qeveria ka sjellë në mënyrë ligjore një projektligj që të shqyrtohet në Kuvend, e obligon komisionin tonë ta marrë në shqyrtim brenda kompetencave që ka. Kurse vlerësimet politike, është mirë t'i ruajmë për seancë, ku partitë politike marrin qëndrimet dhe marrin vendim për të mbështetur apo jo. Unë e mbështes këtë propozim të Beharit, sepse nuk dua që EULEX-i të marrë rolin që ka pasur UNMIK-u. Ne jemi shtet i pavarur dhe EULEX-i ka ardhur me kërkesën tonë, prandaj ne duhet të vendosim se deri kur duhet të vazhdojë mandati i EULEX-it. Edhe nëse nesër do të

hynte në fuqi ligji, EULEX-i do të vazhdonte t'i përmbyllte rastet e hapura. Kërkesa jonë për të marrë përgjegjësi është tipike për një vend sovran. Unë sugjeroj që të koncentrohemi në aspektet procedurale të propozimit dhe në seancë t'i shprehim pikëpamjet tona politike.

Ardian Gjini – U pajtua me parafolësin, duke shtuar se nuk ka vullnet për të futur në rend të ditës një pikë të re, nëse nuk e ka diskutuar në grupin e tij parlamentar. Ne pajtohemi me vullnetin tonë që Kosova të jetë një shtet sovran dhe i pavarur, por nuk duhet të marrin një vendim që EULEX-it ia pamundëson të bëjë aktakuza të reja. Sidoqoftë, diskutimet duhet të lihen për seancë, siç theksoi z.Bajrami.

Behar Selimi –Unë e propozova këtë projektligj, sepse ka ardhur në Kuvend më 13 shtator, domethënë nuk është që po ngutemi, dhe nëse e lexoni strategjinë, do të shihni se si strategjia ka dalë si rezultat i konsensusit me faktorin ndërkombëtar. Ne duhet t'i japim mbështetjen ligjore, që kur të vijë koha për t'u transformuar misioni i EULEX-it, pra nga një mision me karakter ekzekutiv, në një mision të karakterit këshillëdhënës. Një ditë, ne do të detyrohemi t'i marrim vetë këto përgjegjësi.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetit Behar Selimi dhe konstatoi se me 2 vota për dhe 5 kundër, Komisioni nuk e përkrahu propozimin.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 11.07 dhe 15.07. 2013

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 11.7 dhe 15.7. 2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit mbikëqyrës të Agjencisë Kosovare të Pronës

Komisioni e shqyrtoi Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-P-073/k, lidhur me propozimin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe vlerësoi se propozimi për emërimin e kandidatëve është në pajtim me Ligjin për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale nr. 03/L-0 79. Prandaj, duke marrë parasysh bazën ligjore të propozimit të Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe obligimin ligjor të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të emërohen anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës:

1. Ujup Krasniqi,
2. Ismajl Osdautaj.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Albulena Haxhiu – Tha se Kosova nuk vuan nga mospasja e ligjeve, por nga moszbatimi i tyre në praktikë. Kështu është edhe rasti për Ligjin e parandalimit të konflikteve të interesit, i cili është miratuar në vitin 2011. Pra, ne jemi dëshmitarë se edhe ky ligj nuk është zbatuar dhe respektuar nga institucionet që janë të thirrura ta zbatojnë këtë ligj. Sa i përket ndryshimeve që janë bërë në këtë projektligj, ndryshimet janë kryesisht teknike, ka shumë referenca të gabuara, ku thuhet se me këtë ligj ndryshohet, mirëpo nuk përputhet me ndryshimin. Në rastet kur shqyrtojmë projektligje të tilla, duhet të jenë prezent përfaqësuesit e ministrisë përkatëse, që janë sponsorizues të projektligjit, si dhe të organizohen dëgjime publike.

Meqë nuk kishte vërejtje tjera, kryetari konstatoi se Komisioni, me vetëm një abstenim, nxori këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për aktet normative

Arsim Bajrami – Duke folur për projektligjin, tha se është një projektligj shumë i rëndësishëm. Si komision, kur kemi diskutuar programin e punës së Komisionit për këtë vit, e kemi vlerësuar të nevojshëm që ta kemi një ligj të tillë. Ka qenë edhe ideja që ne të marrim iniciativën që të sponsorizojmë këtë ligj dhe është me rendësi që ne të vendosim rend të ligjeve në komisionin e ligjeve. Ky ligj duhet të unifikojë standardet e ligjeve, sepse jemi dëshmitar se çfarë ligjesh na sjellin me teknika të ndryshme legjislative. Unë angazhohem që të punoj shumë seriozisht në këtë projektligj, ta kalojmë në lexim të parë, të formojmë grupin punues, të punojmë intensivisht, të organizojmë edhe një punëtori. Ka mjaft donatorë që do ta mbështesin atë punëtori. Duhet ta amendamentojmë dhe e kemi një rast shumë të mirë të bëjmë një ligj organik, që do të mund t'i mbijetojë disa legjislaturave.

Kryetari konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji nr. 04/L-229 për aktet normative.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-202 për sistemin e lejeve dhe licencave

Kryetari – Tha se është një projektligj i hartuar shumë keq. Ai paraqiti vërejtje në nenin 15, paragrafi 3 të projektligjit dhe në amendamentin 18, me të cilin është përcaktuar autoriteti, me cilësi të agjencisë së pavarur, që mund të propozojë projektligje në Kuvend, e që është në kundërshtim me neni 79 të Kushtetutës. Po ashtu, edhe në neni 3, përkufizimet në projektligj, nuk e kanë qartësinë e duhur normative dhe ngatërrohen nocionet “lajmërim, leje, lejim, regjistrim dhe person”. Po ashtu, është bërë gabimisht përkufizimi: “Person-person fizik apo subjekt ligjor”, sepse subjektet e së drejtës janë personat fizikë dhe juridikë. Ai paraqiti vërejtje edhe për nenet: 4,5,6,2, 7,2,19,3, 20, 21,32, të cilat kanë paqartësi të theksuar juridike dhe janë pa efekt normativ. Sa i përket amendamenteve, ai tha se

janë kryesisht teknike dhe nuk e ndryshojnë përmbajtjen e projektligjit. Sugjeroi që raporti t'i kthehet Komisionit FunkSIONAL, me rekomandimin që të mos miratohet projektligji.

Meqë nuk kishte vërejtje tjera, kryetari konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

1. Të mos miratohet Projektligji nr. 04/L- 202 për sistemin e lejeve dhe licencave.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre

Kryetari – E paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje për projektligjin dhe amendamentet e propozuara.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre, me amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi